

Procedurat që ndjekin funksionarët e lartë për të marrë vendime

Procedurat që ndjekin funksionarët e lartë për të marrë vendime janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në mbështetje të ligjit Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe Vkm nr. 135, datë 074.03.2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar, Shërbimi Social Shtetëror përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili bazuar mbi legjislacionin në fuqi për zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të institucionit, përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit; nxjerr urdhra dhe udhëzime për veprimtarinë e strukturave të institucionit, në nivel qendror dhe rajonal, në fushën e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe unifikon praktikën e punës së drejtorive rajonale; bashkërendon veprimtarinë e institucionit me organet e tjera qendrore, rajonale dhe vendore në fushën e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror; siguron zbatueshmërinë e politikave dhe të legjislacionit që rregullojnë veprimtarinë në fushën e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror në të gjitha nivelet; përcakton objektivat specifike vjetore dhe treguesit, si edhe është përgjegjës për realizimin e objektivave specifike të miratuara nga ministri.

Veprimtaria e Shërbimit Social Shtetëror dhe vendimmarrja e titullarit mbështeten në Ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.